

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nafta në 229 lekë litri, Braçe: Edhe Kosova furnizohet nga të njëjtët shitës që na shesin edhe ne, por nuk e ka rritur çmimin
ADRESA	https://tpz.al/rritja-e-cmimit-te-naftes-ne-299-leke-litri-brace-edhe-kosova-furnizohet-nga-te-njejtet-shites-qe-na-shesin-edhe-ne-por-nuk-e-ka-rritur-cmimin-i332839
BURIMI	tpz.al
GJENDJA	online

KOHA

KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 18:55:38 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	13 shtator 2026, 16:56:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	897ae9f721040534a07100e7a0da4d8e3b7b3a72879e629d11cbd14b0368a2d7
TEKSTI	06e7ec3a80ba7bd77496e3c6d61d94a434fe3125ac335d9c63354953c338c7db
PAMJA	6b447a584fcac0e9b2f8d2fb9efd4009806fe69e234dd7800f61a6ece32458b4

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	66ad75e79b5f
-----------	--------------

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET, 13 SEPTEMBER 2026, 18:56

Nafta në 229 lekë litri, Braçe: Edhe Kosova furnizohet nga të njëjtët shitës që na shesin edhe ne, por nuk e ka rritur çmimin

tpz.al TPZ



Deputeti socialist Erion Braçe ka reaguar për rritjen e çmimit të naftës, duke ngritur pikëpyetje mbi mënyrën se si funksionon tregu i karburanteve dhe strukturën e taksave e tarifave që përfshihen në çmimin final.

Braçe thekson se çmimi i naftës ka arritur në 229 lekë për litër, duke u rritur me 10 lekë që nga dita e djeshme, ndërkohë që vendet fqinje nuk kanë marrë një hap të tillë.

"Nafta 229 lekë, nuk është thjesht një produkt dhe një çmim. Është rritur që dje me 10 lekë! Cent më cent, është 2.48 euro! Fakt është që secili nga vendet kufitare me ne nuk e ka ndryshuar çmimin as dje, as sot: Mali i Zi ka një çmim prej 1.87 euro, Kosova ka një çmim prej 1.76–1.85 euro, Maqedonia ka një çmim prej 1.64 euro.

Po e përsëris, këto janë çmime që nuk janë ndryshuar dje, as sot! Patjetër që do të pyes: Çfarë po ndodh? Për më tepër që Kosova furnizohet nga të njëjtët shitës që na shesin edhe ne", shprehhet Braçe.

Braçe u drejton dy kërkesa aktorëve që monitorojnë tregun, garantojnë konkurrencën dhe përcaktojnë politikën fiskale. Së pari, ai kërkon që të analizohet modeli i tregut të

panjonur dhe ndarja e pernumeve perseri e tulle); pra, ne te gjithe operacionin tregtar kemi vetem një-dy operatorë!

[Shiko të tjera video](#)

E dyta, është momenti për të parë strukturën e taksave dhe tarifave të futura brenda çmimit të naftës, duke filluar nga ato që nuk kanë lidhje me çmimin, por me taksa e tarifa për të cilat shteti ka institucione që paguhen shtrenjtë; duke nisur nga taksa e qarkullimit, për të vijuar me tarifa shërbimesh pa asnjë lidhje me çmimin. Duhet bërë tani! Duhet të jesh pa sy e mendje për të mos parë e kuptuar që vetëm nga eliminimi i tregtisë dhe kontrabandës me fqinjët, do të fitohet shumë më tepër se sa nga ky çmim", përfundon Braçe.

AKTUALITET / 13 September 2026, 17:52

[Reforma territoriale, Rama nga Berati: Poliçani dhe Dimali do të marrin të njëjtat shërbime, por brenda bashkisë Berat](#)

AKTUALITET / 13 September 2026, 16:41

[Aktorja Egla Ceno tregon përballjen me kryeministrin Rama në Berat: Doja të flisja, ai u çua i irrituar](#)

AKTUALITET / 13 September 2026, 16:13

[Dënohet agjenti imobilar, u siguroi shqiptarëve 19 shtëpi në Angli për të mbjellë kanabis me vlerë 2 milionë sterlina](#)

AKTUALITET / 13 September 2026, 15:23

[Zbulohen detaje nga ngjarja e rëndë në Vorë, 56-vjeçari i la kushëririt plumbin në zarf në derën e shtëpisë](#)

AKTUALITET / 13 September 2026, 14:12

Takimi në Berat, debate mes kryeministrit, kryebashkiakut të Poliçanit dhe aktores

AKTUALITET / 13 September 2026, 14:08

Parandalohet ngjarja e rëndë në Rrogozhinë, arrestohet i riu që kanosi me kallashnikov 35-vjeçar

AKTUALITET / 13 September 2026, 13:04

Taksat e naftës mbushin arkën e shtetit, 1.7 miliardë lekë më tepër që nga marsi

AKTUALITET / 13 September 2026, 12:46

Pagat e magistratëve, Rama: Të gjithë të respektojnë Kushtetutën, askush nuk mund të kërcënojë askënd

AKTUALITET / 13 September 2026, 12:28

Dyshohet se kanosi kushëririn e tij për t'i marrë 300 mijë euro, arrestohet në Vorë 56-vjeçari

AKTUALITET / 13 September 2026, 11:17

Stuhia godet Elbasanin, uji pushton banesa, bodrume dhe parkime nëntokësore (VIDEO)

AKTUALITET / 13 September 2026, 11:09

'PISA 2025', pasqyra e deformuar e suksesit të qeverisë me arsimin

AKTUALITET / 13 September 2026, 10:18

Mbi 30 plumba ndaj makinës së familjes që u kthye nga Italia, autorët djegin mjetin në Urakë

AKTUALITET / 13 September 2026, 10:13

Ngërçi me pagat e gjyqtarëve,
Rama: Gjykatësi fillestar në
Shqipëri merr 500 euro më
shumë se kolegët në Greqi

AKTUALITET / 12 September 2026, 22:59

FOTO/ Pak ditë pas
sekuestrimit të 80 kg kokainë,
zbulohet tjetër sasi e madhe
pranë vilës së Lulzim Cakës
në Greqi, ja ku ishte fshehur

AKTUALITET / 12 September 2026, 22:48

Tritoli në banesën e mësuesit
në Shkodër/ Policia: Vetëm
dëme materiale, vijon puna
për kapjen e autorëve

AKTUALITET / 12 September 2026, 22:41

Rama: Bashkimi Vlorë–
Selenicë në funksion të
fuqizimit ekonomik dhe social
të komuniteteve

AKTUALITET / 12 September 2026, 22:31

Shpërthimi me tritol në
banesën e 60-vjeçarit në
Shkodër/ Zbardhet identiteti i
pronarit

AKTUALITET / 12 September 2026, 22:20

Balla nga Prishtina: Më 16
shtator, Gjykata Speciale
duhet të shpallë pafajësinë e
plotë të Thaçit dhe ish-
krerëve të UÇK-së

AKTUALITET / 12 September 2026, 22:06

Shpërthim me tritol në
Shkodër/ Lënda plasëse
hidhet në oborrin e një banese
pranë Bashkisë

AKTUALITET / 12 September 2026, 22:03

105 ditë protestë/ Diaspora
mbush Bulevardin: Dorëheqje!
Ju erdhi fundi

[KONTAKT](#)[PRIVACY POLICY](#)[COOKIES](#)[NJOFTIME NGA TPZ.AL](#)

tpz.al

TPZ.al është një media online e pavarur. Përpjekja jonë është të sjellim lajme, analiza dhe komente, në shërbim të interesit publik.

[AKTUALITET](#)[IDE](#)[NË FOKUS](#)[BALLKAN](#)[BOTA](#)[LIFESTYLE](#)[SPORT](#)[TEJ E KETEJ](#)[BLOG](#)[EMISIONE](#)

Built & Monetized by **Mediadesk**

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.